

KËRKESË PËR LICENCË

Në zbatim të ligjit nr. 61/2023 "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale"

1. TË DHËNAT E SUBJEKTIT APLIKUES

Emri i subjektit (i personit juridik): _____
Numri i identifikimit (NUIS/NIPT): _____
Adresa: _____
e-mail: _____
Numër kontakti: _____

Të dhënat e personit që kryen aplikimin

Vendosni ☒ nëse personi që kryen aplikimin është administrator/përfaqësues ligjor apo person i autorizuar nga subjekti aplikues. Në rast të zgjedhjes së këtij të fundit, bashkëlidhni aktin e përfaqësimit (autorizimin e përfaqësimit/prokurën).

☐ Administrator/ përfaqësues ligjor ☐ Person i autorizuar nga subjekti aplikues

Emër Mbiemër: _____
Atësi: _____
Datëlindje: _____
Vendlindje: _____
Vendbanim: _____
Numër identifikimi: _____
e-mail: _____
Numër kontakti: _____

2. LLOJI I LICENCËS SË KËRKUAR

Vendosni ☒ për çdo aktivitet për të cilin aplikoni.

Licenca jepet për një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 14, të ligjit nr. 61/2023:

- ☐ Kultivim dhe prodhim i bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore.
☐ Transport i farërave, bimëve dhe produkteve e nënprodukteve të cannabis-it për qëllime mjekësore në territorin e Republikës së Shqipërisë.
☐ Eksport i bimëve, produkteve dhe nënprodukteve të cannabis-it për qëllime mjekësore.

2.1. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT PËR TË CILIN KËRKOHEM LICENCA

Në rast se nevojitet hapësirë shtesë, bashkëlidhni faqe të nënshkruara dhe të vulosura.

2.2. NUMRI DHE SIPËRFAQJA E NJËSIVE

Licenca mund të përfshijë deri në 4 njësi, të cilat duhet të jenë kufitare me njëra-tjetrën. Sipërfaqja e çdo njësie: minimumi 5 hektarë, maksimumi 10 hektarë (sipas pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr. 61/2023).

☐ 1 njësi	☐ 2 njësi	☐ 3 njësi	☐ 4 njësi
----------------------------------	----------------------------------	----------------------------------	----------------------------------

Përshkruani sipërfaqen, koordinatat, zonën kadastrale dhe vendndodhjen e njësisë/njësive:

3. AKTIVITETE QË DO TË KRYHEN NGA SUBJEKTE TË TRETA

Në rast të zgjedhjes së opsionit të dytë, aplikanti plotëson të dhënat e mëposhtme për subjektin e tretë të kontraktuar dhe bashkëlidh marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin. Kur aktivitetet kryhen nga më shumë se një subjekt i tretë, ky seksion kopjohet dhe plotësohet veçmas për secilin subjekt.

- ☐ Të gjitha aktivitetet do të kryhen tërësisht vetëm nga aplikanti.
- ☐ Disa nga aktivitetet e parashikuara në licencë mund të kryhen, tërësisht ose pjesërisht, nga subjekte të treta të kontraktuara, në përputhje me pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 61/2023, si dhe me marrëveshjet përkatëse.

Emri i subjektit (i personit juridik): _____

Numri i identifikimit (NUIS / NIPT): _____

Adresa: _____

Emri dhe mbiemri i Administratorit: _____

e-mail: _____

Numër kontakti: _____

Përshkrim i aktivitetit që do të kryejë pala e tretë:

4. DOKUMENTACIONI

4.1 DOKUMENTACIONI I PËRGJITHSHËM

Vendosni ☒ pas çdo dokumenti të bashkëlidhur.

Nr.	Dokumenti	Sqarimet përkatëse	x
1.	Kërkesë për licencë	E plotësuar dhe e nënshkruar	☐
2.	Mandati i arkëtimit të pagesës së tarifës së aplikimit	Mandat bankar që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së aplikimit pranë një banke të nivelit të dytë	☐
3.	Të dhënat e njësisë: koordinatat dhe marrëdhënia juridike me tokën	Certifikatë pronësie, kartelë pasurie, fragment i hartës kadastrale, vërtetim regjistrimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës; ose kontratë qiraje me afat 15 vjet, e noterizuar	☐
4.	Plani i zhvillimit të biznesit	Modeli i kultivimit, qëllimi i kultivimit, sipërfaqja minimale dhe maksimale e njësive, analiza tregu, plan marketingu për tregjet ndërkombëtare, strukturë organizative, vlerësim i ndikimit në mjedis, plan operacional dhe financiar, etj.	☐
5.	Planvendosja e ambienteve brenda njësisë	Skemë teknike/inxhinierike e ndarjes së mjedisëve, leje mjedisore/ndërtimore; sisteme kontrolli temperaturash, ndriçimi, ventilimi, filtrimi; projekt elektrik, projekt hidraulik	☐
6.	Plani i sigurisë	Sipas kriteve dhe kushteve të VKM-së nr. 8, datë 09.01.2025 “Për përcaktimin e standardeve të planit të sigurisë e të elementeve të mbrojtjes për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim të bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe rregullave të lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para dhe produkteve që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara”	☐
7.	Deklaratë noteriale	Përmbajtja e deklaratës noteriale sipas shtojcës nr. 7, si dhe sipas pikës 1, nenit 11, të Udhëzimit nr. 5, datë 20.1.2025 “Për mënyrën e hollësishme të asgjësimit të bimëve të cannabis-it”	☐
8.	Certifikatë e regjistrimit në QKB	Kopje e njësuar me origjinalin	☐
9.	Ekstrakt historik i subjektit juridik; akti i themelimit dhe statuti; lista e pronarëve përfitues (nëse ka)	Gjeneruar nga portali e-Albania me vulë elektronike; vlefshmëri 3 muaj nga data e lëshimit të dokumentit	☐
10.	Certifikata e Sigurisë Industriale (CSI)	Lëshuar nga AKSIK, sipas Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe VKM-së nr. 659/2024; vlefshmëri deri 5 vjet	☐

11.	Dokument që vërteton kapital të shoqërisë jo më të vogël se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë	Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para	☐
12.	Vërtetim nga organi përmbarues që provon se subjekti nuk është në ekzekutim të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera	Portali e-Albania; vlefshmëri 30 ditë nga data e lëshimit të dokumentit	☐
13.	Vërtetim që provon se subjekti, ortakët ose aksionarët nuk janë në procedurë falimentimi	Gjykata e Rrethit Gjyqësor; vlefshmëri 6 muaj nga data e lëshimit të dokumentit	☐
14.	Pasqyrat financiare të subjektit dhe aksionarëve të tij për 3 vitet e fundit	Pasqyrat financiare të audituara, në version PDF (të skanuara)	☐
15.	Dokumente që vërtetojnë përvojën jo më pak se 3 vjet në aktivitetet kryesore, si: prodhimi, kultivimi dhe qarkullimi i bimës së <i>cannabis</i> -it për qëllime mjekësore	Regjistri tregtar, kontrata të realizuara, fatura, certifikata, kontrata pune ose certifikata shërbimi	☐
16.	Dokument që vërteton ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit në një nga vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, për të paktën 5 vjet	Certifikata regjistrimi, licenca, kontrata, vërtetime nga autoritetet kompetente, dokumente tatimore ose dokumente të tjera ekuivalente që vërtetojnë ushtrimin e veprimtarisë	☐
17.	Dokumentacion që vërteton zotërimin e praktikave të mira të prodhimit, sipas standardeve EU-GMP ose FDA/cGMP gjatë historikut të aktivitetit, për të paktën 3 vjet	Certifikatë EU-GMP/ deklaratë cGMP/ raport inspektimi FDA	☐
18.	Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen e detyrimeve tatimore si nga subjekti, ashtu edhe nga çdo subjekt juridik në rast bashkimi shoqërisë	Portali e-Albania, shërbimi “Vërtetim për pagim detyrimesh”	☐
19.	Rregullore e brendshme e funksionimit të aktivitetit	Proceset e brendshme administrative dhe operacionale të veprimtarisë	☐

4.2 DOKUMENTACIONI PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS

Ky dokumentacion kërkohet për secilin nga personat e mëposhtëm: pronarët/ortakët/aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese, administratorët, drejtuesit teknikë, punonjës dhe për çdo subjekt të tretë të identifikuar në vetëdeklarim. Vendosni ☒ pas çdo dokumenti të bashkëlidhur.

Nr.	Dokumenti	Sqarimet përkatëse	x
1.	Jetëshkrim	<i>Format standard Europass; plotësuar dhe nënshkruar</i>	☐
2.	Vetëdeklarime	<i>për dhënien e pëlqimit për mbledhjen, përpunimin dhe trajtimin e të dhënave personale, si dhe për kryerjen e procedurave të verifikimit të pastërtisë së figurës (aneksi nr.1) ;</i>	☐
		<i>mbi gjendjen gjyqësore (aneksi nr.2);</i>	☐
		<i>për konfliktin e interesit (aneksi nr.4 ose aneksi nr.4/1);</i>	☐
		<i>për masat disiplinore (aneksi nr.5 dhe aneksi nr.5/1 plotësohet nga pronarët/ortakët/aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese, administratorët, drejtuesit teknikë¹)</i>	☐
		<i>aneksi nr. 5/2 plotësohet nga punonjësit që kryejnë proceset bazike të punës);</i>	☐
		<i>mbi gjendjen gjyqësore (aneksi nr.6).</i>	☐
	Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar që vërteton se, nuk është në hetim në fushën e narkotikëve, në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal apo krim të organizuar	<i>Lëshuar pas paraqitjes së kërkesës së dërguar nëpërmjet postës</i>	☐
	Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës	<i>Kopje e lexueshme në version PDF (e skanuar)</i>	☐
	Certifikatë e gjendjes familjare dhe personale	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile; portali e-Albania</i>	☐
	Vërtetim nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML), që nuk është përdorues droge ²	<i>Vërtetimi merret pasi janë kryer analizat në IML të cilat vërtetojnë se nuk është përdorues i drogave përfshirë dhe cannabis-in³</i>	☐
	Certifikatë e gjendjes gjyqësore	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; portali e-Albania; vlefshëmëri 3 muaj</i>	☐
	Vërtetim nga organi gjyqësor që provon se aplikanti nuk	<i>Lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, me vlefshëmëri 3 (tre) muaj</i>	☐

është në gjykim për ndonjë vepër penale			
9.	Vërtetim nga prokuroria që vërteton se aplikanti nuk është në ndjekje penale	<i>Lëshuar nga prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm të vendbanimit përkatës</i>	☐
10.	Fotokopje e librezës së punës	<i>Për periudhat e punësimit jashtë vendit, si dhe për shtetasit e huaj, duhet të paraqitet vërtetim nga autoriteti përkatës i vendit të origjinës, që dëshmon natyrën dhe marrëdhënien e punës</i>	☐
11.	Fotokopje e noterizuar e diplomës së arsimit të lartë	<i>Diplomat e studimeve të kryera jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe të njësura sipas legjislacionit shqiptar nga ministria përgjegjëse për arsimin</i>	☐
12.	Vërtetim i gjendjes shëndetësore	<i>Për shtetasit e huaj që nuk janë rezidentë në Shqipëri, ky vërtetim të lëshohet nga autoriteti përkatës i vendit të origjinës</i>	☐
13.	Çdo dokument tjetër vërtetues i kualifikimeve, trajnimeve ose vlerësimeve pozitive të cituara në jetëshkrim	<i>Sipas informacionit të deklaruar në jetëshkrim</i>	☐

Shënime:

¹ Për periudhat e punësimit në një shtet të huaj, paraqitet një letër reference nga punëdhënësit e shtatë viteve të fundit

² Ky dokument kërkohet për personat fizikë të angazhuar në funksione operacionale, teknike, drejtuese ose sigurie, sipas udhëzimit përkatës. Për kategoritë e tjera, dokumenti kërkohet vetëm kur është i nevojshëm, i zbatueshëm dhe proporcional me funksionin konkret të personit në subjekt.

³ Për pronarët, ortakët, aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese, administratorët, drejtuesit teknikë apo punonjësit që janë shtetas të huaj me rezidencë jashtë vendit, të cilët, për arsye objektive, e kanë të pamundur kryerjen e testit sipas specifikimeve të mësipërme, testimi mund të kryhet në shtetin e tyre të rezidencës, në një institucion homolog me Institutin e Mjekësisë Ligjore, sipas orientimeve të strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

5. FORMULARI I VETËDEKLARIMEVE

A PUNËSIMI I PERSONELIT

Deklaroj se shoqëria do të punësojë personelin sipas kriterëve dhe kushteve të germës “dh”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023 dhe Udhëzimit nr. 274, datë 16.05.2024, të ndryshuar:

- Të paktën 10 persona të punësuar për çdo njësi prodhimi.
- Të paktën 2 persona me kualifikim në fushën e farmacisë dhe/ose agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse.
- Personeli i punësuar plotëson kriteret etiko-profesionale dhe të pastërtisë së figurës sipas Udhëzimit nr. 274/2024, të ndryshuar.

B GATISHMËRIA PËR MARRËVESHJE ME MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE

Deklaroj gatishmërinë e shoqërisë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse të Ministrisë për rendin dhe sigurinë publike, në nivel qendror dhe vendor, sipas germës “e”, pikës 2, nenit 15 të ligjit nr. 61/2023, për:

- Garantimin e aksesit për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike që mbikëqyr mjediset e kultivimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve dhe produkteve të saj.
- Respektimin e rregullave të lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para dhe produkteve, sipas VKM-së nr. 8, datë 9.01.2025.

C FILLIMI I USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË BRENDË 12 MUAJVE

Deklaroj se shoqëria do të fillojë ushtrimin e veprimtarive të përshkruara në licencë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të licencës, që përfshijnë ngritjen e infrastrukturës, zbatimin e standardeve të sigurisë, punësimin e personelit dhe lidhjen e marrëveshjeve të nevojshme, sipas germës “ë”, pikës 2, të nenit 15, ligjit nr. 61/2023.

D TARIFA VJETORE

Deklaroj se pas periudhës 3-vjeçare nga licencimi, shoqëria do të kryejë çdo vit pagesën e tarifës vjetore të barabartë me 1.5% të qarkullimit vjetor, por, në çdo rast, jo më pak se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, sipas germës “f”, pikës 2, të nenit 15 të ligjit nr. 61/2023.

E GARANCIA BANKARE

Deklaroj se shoqëria do të kryejë pagesën e garancisë bankare në masën 10% të vlerës së investimit, brenda afatit 30-ditor pas përfundimit të fazës së ankimit dhe njoftimit zyrtar nga Agjencia, sipas germës “g”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023.

F	GJURMUESHMËRIA DHE KRYERJA E PAGESAVE TË SISTEMIT TË GJURMIMIT
----------	---

Deklaroj gatishmërinë e shoqërisë për plotësimin e të gjitha kërkesave të gjurmueshmërisë, sipas parashikimeve të germës “gj” dhe “i”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 61/2023:

- Pajisjen me etiketë për bimën, nënproduktet dhe produktet e *cannabis*-it;
- Disponibilitetin për kryerjen e pagesave të tarifave të sistemit të gjurmimit, sipas parashikimeve ligjore;
- Plotësimin e të gjitha kërkesave teknike dhe operacionale të sistemit të gjurmueshmërisë.

G	PROCESET QË KRYHEN NGA SUBJEKTE TË TRETA
----------	---

Deklaroj se proceset që do të kryhen nga subjekte të treta dhe identifikimi i tyre me të dhëna të sakta janë pasqyruar në këtë vetëdeklarim, me qëllim mundësimin e vlerësimit dhe verifikimit, sipas germës “h”, të pikës 2, të nenit 15 të ligjit nr. 61/2023:

Në rast se deklarohet më shumë se një subjekt i tretë, bashkëngjiten faqe shtesë të nënshkruara dhe të vulosura. Pas pajisjes me licencë, subjekti dorëzon pranë Agjencisë kontratat e lidhura me subjektet e treta brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tyre.

Të dhënat e palës së tretë

Emri i subjektit (i personit juridik): _____

Numri i identifikimit (NUIS/NIPT): _____

Adresa: _____

Emri dhe mbiemri i Administratorit _____

e-mail: _____

Numër kontakti: _____

Objekti i marrëveshjes

Përshkrim aktivitetit që do të kryejë pala e tretë:

H	MARRËVESHJE PARAPRAKE PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË FIZIKE
----------	---

Deklaroj se shoqëria ka lidhur marrëveshjen e sigurisë fizike me SHPSF-në, sipas germës “dh” të nenit 16, të ligjit nr. 61/2023, duke përmbyllur kushtet e përcaktuara nga struktura përgjegjëse e Ministrisë për rendin dhe sigurinë publike, dhe angazhohem të njoftoj menjëherë Agjencinë për çdo ndryshim.

Të dhënat e Shoqërisë Private të Sigurisë Fizike (SHPSF)

Emri i SHPSF-së: _____
Numri i identifikimit (NUIS/NIPT): _____
Adresa: _____
Emri dhe mbiemri i Administratorit: _____
e-mail: _____
Numër kontakti: _____

Kushtet e marrëveshjes

Objekti i marrëveshjes: _____
Kohëzgjatja: _____

Unë i nënshkruari, si Administrator/Përfaqësues Ligjor i shoqërisë, deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se:

- Shoqëria ka dijeni të plotë mbi të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Të gjitha informacionet, të dhënat dhe deklaratat e përfshira nga seksioni A deri në seksionin H të këtij formulari janë të vërteta, të plota dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Në çdo rast ndryshimi të situatës së deklaruar më sipër, angazhohem të njoftoj menjëherë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it dhe të dorëzoj dokumentacionin e përditësuar.
- Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar drejtuar një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit nga autoritetet kompetente, konfirmoj vërtetësinë dhe saktësinë e plotë të të dhënave.
- Çdo deklaram i rreme, fshehje e të dhënave ose paraqitje dokumentacioni të falsifikuar sjell refuzimin ose përjashtimin e aplikimit, pezullimin/shfuqizimin e licencës kur zbulohet pas licencimit, njoftimin e organeve kompetente dhe përgjegjësi penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Deklaruesi Emri i Shoqërisë: _____ Përfaqësuesi Ligjor: (emër, mbiemër) _____ Nënshkrimi: _____ Data: __ / __ / ____	(Vula zyrtare)
---	-----------------------